



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-16192/24 datë:01.07.2024



Npi – 01/233 datë: 02.07.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 02.07.2024, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -VII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 02.07.2024 (e martë) në ora 15:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, znj.Shkurte Behluli, dhe z.Arton Demiri. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: znj.Vlora Hyseni nga zyra për Informim. Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 21.06.2024,
2. Raporti i punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës. Në vazhdim, Konstatoj Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 21.06.2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 21.06.2024.**

Pika 2

Raporti i punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Për këtë pikë nuk kemi se kush na e prezanton nga ekzekutivi, nuk e di se a duhet që ta bëjmë një rekomandim për këtë pikë apo jo? Unë e kam lexuar pak dokumentin i cili ishte mjaft voluminoz, por aty unë nuk pashë diçka të shkruar për sa i përket punës të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, ne e kemi marrë materialin për këtë pikë nga sekretaria e Kuvendit. Edhe unë e pashë raportin por edhe unë nuk pashë një raport nga ZKKK-ja, por kjo nuk po më Judit fare meqenëse nuk e kemi përgjegjësin e Zyrës për ta bërë një raport. Kryetari së shpejti do ta plotëson

këtë zyre me dy zyrtarë. Nuk e kemi të obliguar që ta bëjmë një rekomandim për këtë pikë. Sigurisht që gjatë realizimit të projekteve gjatë kësaj periudhe janë prekur direkt ose indirekt edhe familjet dhe pjestarët e komunitetit pakicë. Ne e kemi një Ushtrues Detyre në këtë zyre që është znj.Elifete Shabani, nuk e di nëse ajo është kontaktuar për ta bërë një raport të tillë të punës.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, Unë kam mbajtur takime të shpeshta pune me U.D. znj.Elifete Shabani. E di që më ka thënë se janë në pritje edhe 6 kërkesa. Po ashtu e di që në ZKKK-ë nuk është bërë asnjë aktivitet dhe nuk ka se qka me u raportuar. Alokimi ka me u bërë në muajin Korrik. Kemi një bashkpunim me IOM-in për sa i përket përfitimit të projekteve deri në 3 mijë euro. Në këtë projekt participon edhe Komuna e Shtimes dhe mund të konkurojnë secili individualisht.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë jam i mendimit që ne si Komitet ta bëjmë një Rekomandim për Kuvendin që ta miratojë Raportin 6 mujor të punës së ekzekutivit, e poashtu në këtë rekomandim ta paraqesim edhe shqetësimin tonë për mungesë të informatave sa i përket Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim. Në vazhdim, Konstatoj Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Komunitete, në mbledhjen e -VII- për vitin 2024 të mbajtur me 02.07.2024, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit të Komunës së Shtimes, që ta miratoi Raportin e Punës të Ekzekutivit të Komunës së Shtimes për periudhën Janar – Qershor 2024, me vërejtjen që në raport nuk ka pas informata për punën e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.**

Pika 3

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, dua që ta falënderoj drejtorin për Buxhet dhe finanacë z.Besnik Ahmetin, për punën dhe përkushtimin e tij, sidomos për sa i përket prezentimit në mbledhjet e Komitetit për Komunitete. Po ashtu e shfrytëzoj rastin që nga këtu ti uroj z.Besnik Seferit lindjen e djalit. Në vazhdim e hapi diskutimin për këtë pikë.

Meqenëse diskutime nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 15:33h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

